



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Komuna e Prishtinës
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik "AS TECH" Sh.P.K. të datës 28.07.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimatizimit, ngrohjes qendrore dhe objekteve komunale" me nr. të prokurimit 616-26-6175-1-3-6, Komuna e Prishtinës (Autoriteti Kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik "AS TECH" Sh.P.K. të datës 28.07.2026 kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimatizimit, ngrohjes qendrore dhe objekteve komunale" me nr. të prokurimit 616-26-6175-1-3-6.
- II. LEJOHET** autoriteti kontraktues që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit me të dhënat si në pikën I të këtij vendimi.
- III. NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi** hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

Arsyetim

Operatori ekonomik "As Tech" Sh.P.K. (tutje "parashtruesi") me datë 28.07.2026 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull "Furnizimi dhe mirëmbajtja e klimatizimit, ngrohjes qendrore dhe objekteve komunale" me nr. të prokurimit 616-26-6175-1-3-6.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet e parashtruesit janë cituar si në vijim:

Pretendimi 1 – Afat i kundërligjshëm dhe joproporcional për dorëzimin e ofertave

Njoftimi për kontratë është publikuar më 28.07.2026, ndërsa hapja e ofertave është caktuar më 03.08.2026, duke lënë një periudhë jashtëzakonisht të shkurtër si për përgatitjen e ofertave, ashtu edhe për ushtrimin efektiv të së drejtës për kërkesë për rishqyrtim.

Praktikisht, operatorëve ekonomikë u është lënë vetëm një ditë efektive për të analizuar dosjen e tenderit dhe për të identifikuar shkeljet eventuale, gjë që e bën pothuajse të pamundur ushtrimin real të të drejtave të garantuara me Ligjin për Prokurimin Publik. Një veprim i tillë bie ndesh me parimet e transparencës, konkurrencës së ndershme dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë. Vetëm ky fakt është i mjaftueshëm për të vënë në dyshim ligjshmërinë dhe integritetin e këtij aktiviteti të prokurimit.

Pretendimi 2 – Bashkimi i shërbimeve të papërputhshme dhe kufizimi i konkurrencës

Autoriteti Kontraktues ka bashkuar në një aktivitet të vetëm projektimin dhe shërbimet për sistemet e klimatizimit dhe të ngrohjes qendrore, ndonëse bëhet fjalë për fusha teknike të ndryshme që kërkojnë ekspertizë të veçantë.

Një operator ekonomik i specializuar në sistemet e klimatizimit nuk është domosdoshmërisht i specializuar edhe në sistemet e ngrohjes qendrore dhe anasjelltas. Ky grupim artificial nuk është arsyetuar në dosjen e tenderit dhe ka efekt të drejtpërdrejtë në kufizimin e konkurrencës, duke përjashtuar operatorë ekonomikë të specializuar që do të kishin mundësi reale të konkurronin nëse aktiviteti do të ishte ndarë sipas natyrës së shërbimeve.

Pretendimi 3 – Titull mashtrues dhe përshkrim i pasaktë i objektit të kontratës

Titulli i aktivitetit të prokurimit krijon përshtypjen se bëhet fjalë për furnizim dhe mirëmbajtje të sistemeve të klimatizimit.

Megjithatë, analiza e paramasës dhe parallogarisë tregon se pozicionet nuk lidhen me sisteme të klimatizimit, por me klima standarde, kablllo, gypa, demontime dhe materiale përcjellëse.

Ky mospërputhje ndërmjet titullit dhe përmbajtjes së dosjes së tenderit është e papranueshme, cenon transparencën dhe krijon konfuzion tek operatorët ekonomikë. Si pasojë, operatorët që furnizojnë klima standarde mund të mos e identifikojnë aktivitetin

si relevant për ta. Kjo paraqet kufizim të drejtpërdrejtë të konkurrencës dhe cenim të parimit të trajtimit të barabartë.

Pretendimi 4 – Krite joproporcionale dhe diskriminuese

Për një aktivitet të kësaj natyre dhe kësaj vlere, Autoriteti Kontraktues ka vendosur krite të pajustificuara dhe joproporcionale.

4.1 Standardet ISO

Janë kërkuar certifikime ISO pa specifikuar qartë se cilat standarde janë të domosdoshme dhe pa arsyetuar lidhjen e tyre me objektin konkret të kontratës, ISO per cka , per Klima?

Klimatizim? apo Nxemje qendrore?? Në mungesë të një arsyetimi profesional dhe ligjor, kjo kërkesë përbën kufizim të panevojshëm të konkurrencës.

4.2 Kërkesa për Bachelor të Termoenergjetikës të certifikuar nga ndonjë brend i Klimatizimit

Kjo kërkesë është në kundërshtim me vetë përmbajtjen e projektit.

Paramasa nuk parasheh sisteme komplekse të klimatizimit që do të kërkonin një profil të tillë profesional, por kryesisht instalime të klimave standarde, të cilat në praktikë realizohen nga teknikë dhe serviserë të licencuar.

Prandaj, kjo kërkesë është e pajustificuar dhe krijon favorizim të operatorëve të caktuar ekonomikë.

4.3 Kërkesa për punëtor të certifikuar KNX për sistemet AHU

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar një punëtor të certifikuar KNX për sistemet AHU, ndonëse në përshkrimin teknik nuk argumentohet nevoja reale për këtë profil.

Ky kriter nuk është në raport proporcional me objektin e kontratës dhe për pasojë paraqet kusht diskriminues që kufizon konkurrencën pa ndonjë bazë objektive.

4.4 Vlerësimi i rrezikut për stafin

Është kërkuar që operatori ekonomik të dëshmojë se stafi ka të kryer vlerësimin e rrezikut në punë.

Megjithatë, në dosjen e tenderit nuk identifikohet asnjë aktivitet specifik me rrezik të shtuar që do ta justifikonte këtë kërkesë.

Autoriteti Kontraktues nuk ka përshkruar punime në lartësi, objekte me rrezik të shtuar apo kushte të veçanta të punës.

Për më tepër, kjo kërkesë bie në kundërshtim me dispozitat e vetë dosjes së tenderit, pasi lejohet angazhimi i stafit edhe gjatë realizimit të kontratës. Në këtë rast lind pyetja logjike: nëse stafi i angazhuar më vonë nuk posedon dokumentin e kërkuar për vlerësim të rrezikut, a do të konsiderohet operatori ekonomik i papërgjegjshëm dhe oferta e tij do të eliminohet? Dosja nuk jep asnjë përgjigje për këtë situatë, duke krijuar pasiguri juridike dhe hapësirë për interpretim arbitrar.

Përfundimi

Shkeljet e evidentuara nuk janë të natyrës formale, por përbëjnë shkelje serioze të legjislacionit të prokurimit publik dhe të parimeve bazë mbi të cilat zhvillohen procedurat e prokurimit.

Afati jashtëzakonisht i shkurtër, përshkrimi kontradiktor i objektit të kontratës, grupimi i pajustificuar i shërbimeve dhe kriteret diskriminuese dëshmojnë se ky aktivitet nuk është zhvilluar në përputhje me standardet e kërkuara ligjore dhe profesionale, por është vazhdim i praktikave që tash e sa vite Autoriteti juaj i zhvillon kur ka projekte të kesaj natyre, dhe ju e dini mjaft mirë këtë. Është koha të ndalohen praktika të tilla.

Nga mënyra se si është përgatitur dokumentacioni krijohet përshtypja se kriteret nuk janë hartuar për të garantuar konkurrencë të hapur dhe trajtim të barabartë të operatorëve.

Lidhur me pretendimet ankimore të parashtruesit, është gjetur se kjo procedurë është me kuotim të çmimit prandaj afati është në rregull. Po ashtu edhe titulli dhe përmbajtja janë në rregull. Njëkohësisht edhe kërkesat për stafin profesional dhe ISO standardet janë jo vetëm të ligjshme por absolutisht të domosdoshme për të garantuar realizimin e projektit në mënyrë efikase dhe efektive. Duhet sqaruar se kërkesat e DT janë vendosur

në përputhje të plotë me qëllimin dhe specifikat e aktivitetit të prokurimit. Sipas nenit 10 paragrafit 10.3 të RRPP është përcaktuar se njësia kërkuuese ndër të tjera ka përgjegjësinë për të përgatitur detyrën projektuese, projektin, specifikimet teknike, termat e referencës, paramasën dhe parallogarinë. Përmes nenit 11 paragrafit 11.3 të RRPP përcaktohet se zyrtari i prokurimit ndër të tjera në bashkëpunim me njësinë kërkuuese i koordinon dokumentet, projektet, specifikimet, termat e referencës, paramasat, parallogaritë dhe vizatimet. Në këtë rast zyrtari përgjegjës i prokurimit i ka falur besimin e plotë sqarimeve të ofruara nga njësia kërkuuese.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi. Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. lidhur me nenin 62 par. 62.1. të RRPP. Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të RRPP.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 30.07.2026

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit
Komuna e Prishtinës

Këshillë juridike:

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.